



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 korrik 2012

Nr. ref.: RK/272/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI22/12

Parashtruesi

Brahim Krasniqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës
së Kosovës Rev.I. br.58/2008 të 27 dhjetorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Brahim Krasniqi, të cilin e përfaqësojnë avokatët Fikri Shishko dhe Shaip Ramadani ng Prizreni, komuna Lipjan.

Kërkesa e parashtruesit të kërkesës

2. Kontestohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës I. Br. 58/2008 i 27 dhjetorit 2011, me të cilin Gjykata Supreme ka aprovuar revizionin e të akuzuarve dhe ka ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Malishevë C. Nr. 185/ 2006, të 29 janarit 2007 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. Nr. 170/2007 i 6 dhjetorit 2007 dhe ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e parashtruesit.

Objekti i çështjes

- Objekti i çështjes të kontestit pronësoro – juridik është krijuar pas kërkesës për përcaktimin e pronësisë kontestuese ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe personave të tretë, i cili është përfunduar me Aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës rev. I .nr.58/2008 të 27 dhjetorit 2011, me të cilën sipas pohimeve të parashtruesit të kërkesës:

“Brahim Krasniqi nga Prizreni me aktgjykim të pa drejtë dhe të njëanshëm është privuar nga prona e vet. Me të njëjtën, poashtu, është bërë shkelje e së drejtës kushtetues në gjykim të drejtë dhe të paanshëm – neni 31. dhe 46 i Kushtetutës së Kosovës“.

“Aktgjykimi i Gjykatës Supreme rev. I. Nr. 58/2008 është e padrejtë dhe e njëanëshme, me të cilën parashtruesit të kërkesës i është bërë shkelje e të drejtave themelore njerëzore të parapara me Konventë Europiane mbi mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe lirive themelore, në lidhje me Protokollin nr.1, 4, 6, 7, 12 dhe 13 , të nenit 6. në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës mbi mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe lirive themelore të vitit 1952“.

Baza juridike

- Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: “ Ligji “) dhe Rregullit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

- Parashtruesi i kërkesës, më 02 mars 2012 ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejme: “Gjykata“).
- Më 21 maj 2012, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për iniciimin e procedurës së vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit në rastin nr. KI-22-12.
- Më 3 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Prof. dr. Enver Hasani, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

- Parashtruesi i kërkesës, më 3 maj 2002 ka ushtruar akt padi në Gjykatën komunale të Malishevës, kundër H. K. dhe të tjerët nga fshati Drenoc, KK Malishevë. Lënda e padisë – vërtetimi i së drejtës së pronës në pronën e paluajtshme. Padia në këtë gjykatë është regjistruar nën numër C. nr.2 4/2002 .
- Me Aktgjykimin e Gjykatës komunale në Malishevë C.nr. 24 / 2002, të 7 gushtit 2003 është refuzuar si e pabazë kërkesa e paditësit Brahim Krasniqi. Në këtë aktgjykim parashtruesi i kërkesës ka deklaruar ankesë.
- Gjykata e Qarkut në Prizren, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e parashtruesit të kërkesës, kundër aktgjykimit të Gjykatës komunale në Malishevë C. nr. 24/2004 të 7 gushtit 2003, me aktvendimin e vet Ac . nr . 367 /2003 të datës 9 dhjetor

2004, e ka aprovuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si të bazuar dhe e ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës komunale në Malishevë C. nr . 24 / 2002 të 7 gushtit 2003 dhe lëndën e ka rikthyer në gjykim.

11. Gjykata komunale në Malishevë, duke vendosur lidhur me procedurën e përsëritur nxjerr aktgjykimin C. nr. 45/ 2995 të datës 27 qershor 2005, me të cilin sërish e refuzon si të pabazuar kërkesën për kompensim të parashtruesit.
12. Parashtruesi i kërkesës paraqet ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës komunale në Malishevë , C. nr. 45/ 2005 të 27 qershorit 2005 .
13. Gjykata e Qarkut në Prizren, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruesit të kërkesës, për herë të dytë në lidhje me çështjen e njëjtë juridike, me aktvendimin e vet Ac. nr. 406/2005 të 27 qershor 2005.
14. Duke vendosur për herë të tretë për kërkesën e parashtruesit të kërkesës Gjykata komunale në Malishevë, me aktgjykimin C. nr . 185/ 2006 i 29 janarit 2007 lejon kërkesat e paditësit në mënyrën vijuese:

“VËRTETOHET se paditësi Brahim Krasniqi është pronar i ngastrës kadastrale nr. 2410 dhe 2411 edhe për sipërfaqen prej 0.10.89 ha të cilën sipërfaqe pa te drejt të paditurit e kanë përvetësuar , ne vendin e quajtur "Rrahishte" me kulturë arë e kl.6 me sipërfaqe prej 0.59,18 ha si dhe pjesa tjetër pra me kulturë arë e kl.5 në sipërfaqe prej 0.48,28 ha ashtu qe sipërfaqja e përgjithshme është prej 1.08,08 ha fletposedimi nr. 258 ZK Drenoc , me dimenzionet e pjesës kontestuese dhe atë sipas kopjes se planit prej pikës A në gjatësi prej 88.66m deri te pika B1 , nga pika B1 deri te pika C1 me gjatësi prej 51,93m ndërsa gjerësi prej 4m , nga pika C1 deri te pika D1 me gjatësi prej 20.78 m kurse me gjerësi prej 8m , nga pika D1 deri te pika E1 me gjatësi prej 32.67m ndërsa me gjerësi prej 6m, nga pika E1 deri te pika F1 me gjatësi prej 47.42m dhe gjerësi prej 5m, dhe nga pika F1 deri te pika H me gjatësi prej 38.00m ndërsa me gjerësi prej 4 m, ashtu qe sipërfaqja kontestuese prej 0.10,89 ha është pjese e ngastrave kadastrale nr. 2410 dhe 2411 me dimenzionet e cekura si me lart , dhe për këtë DETYROHEN të paditurit H., Xh., M., H. dhe B. që të pranojnë këtë fakt, ndërsa të paditurit H. dhe B., detyrohen që ta pranojnë të drejtën e paditësit për sipërfaqen kontestuese prej 0.10,89 ha duke hequr dorë ndaj pretendimeve pronësore për këtë sipërfaqe kontestuese, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa obligohet Drejtoria për kadastër, gjeodezi dhe pronësi të KK Malishevë që të bartë palujtshmërinë në të gjithë librat kadastral në pronësi të paditësit, në të kundërtën ekzekutimi do të bëhet me detyrim.”

15. Gjykata e Qarkut në Prizren me aktgjykimin Ac. nr. 170/2007, të datës 6 dhjetor 2007, duke vendosur lidhur me ankesën e të akuzuarve H. K. dhe të tj. të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës komunale në Malishevë C. nr . 185/2006 të datës 29 janar 2007, refuzon ankesën e Hasë Krasniqit dhe të tj. si të pa bazuar, dhe e vërteton aktgjykimin e Gjykatës komunale në Malishevë C. nr. 185 / 2006 të datës 29 janar 2007.
16. Pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 170/2007 të 6 dhjetorit 2007, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesve të vet të autorizuar ka paraqitur propozim për ekzekutim të aktgjykimit më 25 janar 2008, i cili propozim është evidentuar në Gjykatë si lëndë E. Nr.78/2008. Ekzekutimi i Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 170/2007 të datës 6 dhjetor 2007 është lejuar më datën 31 janar 2008.

17. Më datën 1 Shkurt 2008, të paditurit H. dhe B. K. kanë parashtruar kërkesë për revizion si mjet i jashtëzakonshëm juridik kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 170 / 2007 e datës 6 dhjetor 2007, ndërsa më datën 21 shkurt 2008, përfaqësuesi i autorizuar i të akuzuarve ka pashtuar kundërshtim në ekzekutimin e lejuar të Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 170/2007, datë 6 dhjetor 2007, ku ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit derisa të nxirret aktvendimi i Gjykatës Supreme sipas kërkesës për revizion.
18. Duke vendosur sipas kërkesës për revizion Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin rev. I. nr.58/2008, datë 27 dhjetor 2011, aprovon revizionin e të akuzuarve H. dhe B. K. dhe NDRYSHON Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. Nr.170/2007 i datës 6 dhjetor 2007, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Malishevë C. nr. 185/2006 të datës 29 janar 2007. Po ashtu REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e parashtruesit me arsyetim:

“... Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e vërtetuar faktike, ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik i gjykatës së instancës më të ultë nuk mund të aprovohet si i drejtë dhe ligjor, sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate me rastin e vërtetimit të gjendjes së tillë faktitke, gabimisht është aplikuar e drejta materiale kur të dy gjykatat e instancës më të ultë kanë gjetur se kërkesa e paditësit është e bazuar“.

“Duke pasur parasysh faktet e pa kontestueshme se sipërfaqja kontestuese nga viti 1954 është punuar dhe shfrytëzuar nga ish pronari tani ndërhyrësi në procedurë A. K. pa u penguar nga paditësi deri në vitin 1981 kur i njejt ngastrën kad.nr.2408 dhe 2409 së bashku me sipërfaqen kontestuese si tërësi iu ka shitur paraardhësve te paditurve H.dhe B. K., te cilëve edhe iu ka dorëzuar në posedim dhe shfrytëzim sipas-gjendjes faktike deri te megjete vjetra qe kanë ekzistuar me ngastrat e paditësit të cilat i kanë punuar pa kurrfarë pengese nga paditësi deri ne vitin 2000 ,se paditësi pas ndarjes me vëllezërit e tij nga viti 1954 nuk e ka ne posedim dhe shfrytëzim sipërfaqen kontestuese për të cilën pretendon se e ka të drejtën e pronësisë në bazë të Fletës poseduese nr.258 ZK. Drenoc ,meqë sipas ekspertizës së ekspertit gjyqësorë nga lëmi i Gjeodezisë Hysen Thaqi të dt. 05.01. 2007 është konstatuar se sipërfaqja kontestuese udhëhiqet sipas ng.kad.nr.2410 dhe 2411 në emër të paditësit në bazë të aerofotografimit i cili pas deshifrimit ka hyrë në fuqi më 01.01.1967.”

“Sipas nenit 20 parag.1 dhe 2 Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore është paraparë se: E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit,në bazë të veprimt juridik, dhe me trashëgim ,ose në bazë të vendimit të organit shtetërorë në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj”.

“Në rastin konkretë paditësi në pjesën kontestuese nuk ka fituar të drejtën e pronësisë me bazë ligjore të parapara sipas dispozitës së lartcekur meqë në shkresa të lëndës nuk ka prova mbi bazën juridike ndërsa Fleta poseduese nuk paraqet prove për fitimin e pronësisë duke pasur parasysh edhe faktin e vërtetuar se paditësi në sipërfaqën kontestuese nuk është në posedim dhe shfrytëzim nga viti 1954”.

“Nga arsyet e cekura si dhe të dhëna të cilat gjenden në shkresat e lëndës kjo Gjykatë, gjeti se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht e kanë zbatuar të drejtën materiale, prandaj të dy aktgjykimet e gjykatave u deshtë të ndryshohen dhe kerkesëepadia si e tillë të refuzohet”.

Pohimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës konsideron se:

“Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, i shoqëruar me shkelje të dispozitave të KPK nenit 225 dhe 224/2, Pasi që praktiken gjyqësore shumë rrallë ndodh që gjykata duke vendosur për revizionin, ta ndryshoj aktgjykimin me formë të prerë dhe vet ta vendos çështjen, pa e arsytuar mirë aktgjykimin e marrë. Pra në rastin konkret, duke mbajtur parasysh ecurinë e procedurës dhe vendimet dhe vendimet e gjykatës së parë dhe të dytë, sipas padisë së paditësit, krijohet bindja e bazuar se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev.I.nr, 58/2008 është i padrejtë dhe i njëanshëm, me të cilin paditësit i janë shkelur të drejtat e njeriut të parapara me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, shoqëruar nga Protokollat Nr. 1, 4, 6, 7, 12 e 13, nenit 6 lidhur me nenin 1 të Protokollit Nr.1 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të njeriut dhe lirive themelore viti 1952, sepse Brahim Kasniqi nga Prizreni, me aktgjykim të padrejtë dhe të njëanshëm është privuar nga prona e tij, Po ashtu Brahim Krasniqit iu është shkelur e drejta kushtetuese për një gjykim të drejte dhe të paanshëm -neni 31 dhe 46 i Kushtetutës së Kosovës”.

20. Sipas pohimeve të parashtruesit të kërkesës *“... po ashtu iu është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, nga fakti se i njëjti ne gjysmën e dytë të vitit t 2009, ka parashtruar propozim pranë Gjykatës Komunale në Malishevë, për përmbartimin e aktgjykimit me formë të prerë, lënda e regjistruar – E.nr, 78/2008., mirëpo sipas kësaj kërkesë gjykata nuk ka vendosur , me gjasë duke e pritur vendimin e gjykatës sipas mjetit të jashtëzakonshëm”.*

21. Parashtruesit e kërkesave i drejtohen Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për:

“Anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.I.nr. 58/2008 datë 27.12.2011, me të cilin aplikantit iu është shkelur e drejta e pronës dhe e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, neni 31 dhe 46 i Kushtetutës së Kosovës, po ashtu ndaj aplikantit janë shkelur të drejtat e njeriut të parapara me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, shoqëruar nga Protokollat Nr.1, 4, 6, 7, 12 e 13, nenit 6 lidhur me nenin 1 të Protokollit Nr.1 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të njeriut dhe lirive themelore viti 1952”.

Vlerësimi i aprovimit të kërkesës

22. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se nenet 31. dhe 46. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe protokollit nr. 1, 4, 6, 7, 12 dhe 13 të GJEDNJ, dhe neni 6 (E drejta në Gykim të DFrejtë) Protokoll 1. i GJEDNJ janë bazë e parashtrësës së tij.

23. Neni 48 i Ligjit mbi Kushtetutën e Republikës së Kosovës parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës është i obliguar që të theksoj qartë cilat të drejta dhe liri i janë shkelë dhe cili është akti konkret i organit publik që parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

24. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të procedurës dhe të drejtës materiale (shih , *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës(GC). Nr.30544/96, paragrafi 28 , Gjykata Evropiane për të drejta njerëzore (GJEDNj) 1999-I).

25. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur kurrfarë dëshmie *prima facie* që tregon shkelje të të drejtave kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99 i datës 31 maj 2005.). Parashtruesi i kërkesës nuk thekson në cilën mënyrë nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe neni 6 (E drejta në Gjykim të Drejtë) Protokollin 1 i GJEDNJ, përkrahin kërkesën e tij, sikurse është paraparë me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.
26. Parashtruesi i kërkesës pohon se i janë shkelur të drejtat në (Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) dhe (Mbrojtja e Pronës) me aplikimin e gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, duke mos theksuar qartë në cilën mënyrë Aktgjykimi ka shkelur të drejtat e tyre kushtetuese.
27. Në këtë rast parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit të cilat i konsideron të pasakta, para Gjykatës Komunale në Malishevë, Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse në çfarëdo mënyre kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Aktvendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06 i datës 30 qershor 2009).
28. Përfundimisht, kushtet për aprovim nuk janë plotësuar në këtë kërkesë. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur t'a mbështesë me prova se me aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
29. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me Rregullin 36 (2b) të Rregullores së Punës i cili parashih se, „Gjykata hedhë poshtë kërkesën si të pa bazuar kur konstaton b) se faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pohimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese“.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues

Kadri Kryeziu

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani